



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:261707
Datë: 14.03.2024
Numri i dokumentit: 05453065

Në ankesën e

AC-I-23-0202

Paditësi/Ankuesi

V N, nga Peja.

kundër

E paditura

NSH, "Utva"(në likuidim), Pejë të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0277 të datës 20 mars 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 14 mars 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktvendimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-15-0277, i datës 20 mars 2023.**

3. Lënda kthehet në rigjykim në shkallën e I-rë të DHPGJS-së, tek gjyqtari përkatës.

4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Procedura para Gjykatave të Rregullta

Me datë, 26 maj 1997, paditësi me një grup tjetër të punëtorëve ka dorëzuar një padi për kompensimin e pagave të pa paguara duke filluar nga 01.06.1995 e deri të merret vendimi përfundimtar gjyqësor mbi padinë. Lënda është regjistruar me numrin C.nr.439/97.

Me datë, 27 tetor 2004, padia për paga e paditësit V N dhe grupit tjetër të punëtorëve është aprovuar nga Gjykata Komunale në Pejë me Aktgjykimin C.nr.133/03, dhe është detyruar NSH Fabrika e Konstruksioneve Metalike "Utva" në Pejë, që secilit punëtor të cekur në dispozitiv të aktgjykimit ti paguhen pagat e papaguara për periudhën prej 01.06.1995 e deri 31.03.1999, secilit veç e veç në shumë prej 4,998.00 euro, me kamatën e paraparë ligjore si për mjetet që deponohen në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padisë 26 maj 1997 e deri në pagesën definitive. Ky aktgjykim në bazë të vulës së plotfuqishmërisë është bërë i plotfuqishëm me 28.12.2004.

Me datë, 22 mars 2005, sipas kërkesës së Prokurorit Publik të Kosovës Pck.nr.10/2005, të datës 16.02.2005, Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Mlc.nr.2/2005, e refuzon si të pa bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit Publik të Kosovës.

Me datë, 20 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë sipas kërkesës së AKP-së për përsëritjen e procedurës të përfunduar me Aktgjykimin e plotfuqishëm, e lejon përsëritjen e procedurës, ndërsa e anulon Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.133/03, të datës 27.10.2004.

Me datë, 8 shkurt 2016, Gjykata Themelore në Pejë me Aktvendimin C.nr.1022/15, e pezullon procedurën gjyqësore lidhur me padinë për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit të NSH Fabrika e Konstruksioneve Metalike "Utva" në Pejë. Me këtë Aktvendim vendoset që procedura e pezulluar mund të vazhdojë pasi të ketë përfunduar procedura e likuidimit, me propozimin e palëve ndërgjygjëse.

Me datë, 20 prill 2016, sipas ankesës së paditësve, Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktvendimin Ac.nr.949/16, e refuzon ankesën e paditësve dhe e vërteton Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.1022/15, të datës 08.02.2016 për pezullim të procedurës.

Procedura para Autoritetit të Likuidimit

Me datë, 05 shkurt 2008, paditësi V N dhe gjashtëdhjetë e nëntë punëtorë të tjerë të NSH "Utva" (në likuidim) e kanë dorëzuar një kërkesë të përbashkët për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën totale për të gjithë punëtorët prej 513,022.57 euro.

Me datë, 03 mars 2015, Autoriteti i Likuidimit me vendimin PEJ091-0049, e refuzon si të pa vlefshme kërkesën e paditësve për kompensimin e pagave të pa paguara. Autoriteti i Likuidimit në vendimin e tij ka arsyetuar se me shkresën e datës 16.10.2014 ka kërkuar nga të gjithë paditësit që ti dorëzojnë Librezat e punës përgjatë viteve 1991-1999, shoqëruar edhe me informata shtesë si dhe të dorëzojnë autorizimin e vlefshëm të përfaqësuesit të tyre para Autoritetit të Likuidimit. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se nga paditësit po ashtu është kërkuar ti dorëzojnë kontratat e punës secili veç e veç. Autoriteti i Likuidimit konstaton se është dhënë një përgjigje në të cilën thuhet se asnjërit nga punëtorët nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës përpara datës 24.08.2005, ndërsa dokumentet e kërkuara është thënë se nuk mund të gjenden, pasi që janë djegur gjatë luftës ose humbur. Autoriteti i Likuidimit konstaton se paditësit e kanë filluar një procedurë lidhur me pagat në Gjykatën Komunale në Pejë, në bazë të padisë së datës 26 maj 1997, duke i kërkuar pagat nga data 01.06.1995 e deri 30.03.1999, mirëpo pas shumë zhvillimeve që ka ndodhur në Gjykata të rregullta, kjo procedurë lidhur me këtë padi është ndërprerë për shkak se NSH-ja është në likuidim. Tutje

Autoriteti i Likuidimit konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.133/03, është anuluar nga Gjykata e Qarkut në Pejë në bazë të kërkesës së AKP-së për lejimin e përsëritjes së procedurës të përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë, dhe çështja është kthyer në rigjykim. Autoriteti i Likuidimit konstaton se paditësit nuk kanë një bazë juridike për njohjen e të drejtës në paga, andaj në kuptim të nenit 36.2 nën paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, është refuzuar kërkesa për paga si e pavlefshme.

Me datë, 01 prill 2015, paditësi V N ka parashtruar një ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit PEJ091-0049, të datës 03 mars 2015, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga DHPGJS-ja që të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit, dhe të detyrohet Autoriteti i Likuidimit të zbatojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.133/03, të datës 27.10.2004, pasi që pretendon se është i plotfuqishëm dhe i ekzekutueshëm. Për më tepër në këtë ankesë paditësi i ka pasqyruar të gjitha zhvillimet procedurale që kanë ndodhur pranë gjykatave të rregullta lidhur me padinë e tij të datës 27 maj 1997. Paditësi në ankesë pohon se pas njoftimit për fillimin e procedurës së likuidimit ndaj NSH-së "Utva" në Pejë ka paraqitur kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit që ti paguan pagat e pa paguara për periudhën e cekur, duke pohuar se ishte dorëzuar edhe dokumentacioni i nevojshëm dhe se pa të drejtë Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën. Bashkë me këtë ankesë paditësi e dorëzon një kopje të padisë të datës 26 maj 1997, një kopje të Aktvendimit të DHPGJS-së SR-11-0001, të datës 04 dhjetor 2013, me të cilën ishte refuzuar kërkesa për tërheqjen e lëndës C.nr.133-03 nga Gjykata Komunale në Pejë, një kërkesë për AKP-në me të cilin është kërkuar dhënia e shënimeve për punëtorë të cilëve u mungojnë Librezat e punës, kopjen e Librit amëz punëtorëve, një listë të NSH-së për punëtorë, kopjet e Librezave të punës për disa punëtorë, si dhe kopjet e Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve të Gjykatave të rregullta të cilave u referohet në ankesë.

Me datë, 24 shkurt 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. Autoriteti i Likuidimit konsideron se objekti i kësaj procedure

është vetëm ligjshmëria e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa paditësi nuk ka treguar cili nen i Ligjit të AKP-së është shkëlur nga Autoriteti i Likuidimit me marrjen e vendimit të ankimuar. Autoriteti i Likuidimit me shkresën e datës 16.10.2014 ka kërkuar nga të gjithë paditësit që ti dorëzojnë Librezat e punës përgjatë viteve 1991-1999, shoqëruar edhe me informata shtesë si dhe të dorëzojnë autorizimin e vlefshëm të përfaqësuesit të tyre para Autoritetit të Likuidimit. Tutje Autoriteti i Likuidimit konstaton se nga paditësit po ashtu është kërkuar ti dorëzojnë kontratat e punës secili veç e veç Autoriteti i Likuidimit konstaton se është dhënë një përgjigje në të cilën thuhet se asnjërit nga punëtorët nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës përpara datës 24.08.2005, ndërsa dokumentet e kërkuara është thënë se nuk mund të gjenden pasi që janë djegur gjatë luftës ose humbur. AKP-ja konstaton se paditësit e kanë filluar një procedurë në Gjykatën Komunale në Pejë, në bazë të padisë së datës 26 maj 1997, duke i kërkuar pagat nga data 01.06.1995 e deri 30.03.1999, mirëpo pas shumë zhvillimeve që ka ndodhur në Gjykata të rregullta, kjo procedurë lidhur me këtë padi është ndërprerë për shkak se NSH-ja është në likuidim. Tutje AKP-ja konstaton se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.133/03, është anuluar nga Gjykata e Qarkut në Pejë në bazë të kërkesës së AKP-së për lejimin e përsëritjes së procedurës të përfunduar me Aktgjykim të formës së prerë, dhe çështja është kthyer në rigjykim. AKP-ja pohon se paditësit nuk kanë një bazë juridike për njohjen e të drejtës në paga, andaj në kuptim të nenit 36.2 nën paragrafi 2 i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, është refuzuar kërkesa për paga si e pavlefshme.

Me datë 20 mars 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-15-0277, ankesën e paditësit e hedhë poshtë si të pa pranueshme pasi që çështja juridike është zgjidhur me Aktgjykimin e plotfuqishëm C.nr.133/03, të datës 27.10.2004 të lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë, dhe kjo çështje është çështje e gjykuar. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se në bazë të nenit 391 paragrafi 1 pika d) të LPK-së është përcaktuar se pas shqyrtimit paraprak të padisë, gjykata me Aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme, poqë se konstaton se çështja e ngritur me padi është çështje e gjykuar. Në rastin konkret nga provat e lëndës rrjedh se në lidhje me kërkesën e paditësit është vendosur nga Gjykata Komunale

në Pejë me Aktgjykimin e formës së prerë C.nr.133/03, të datës 27.10.2004, rrjedhimisht duke u bazuar në rrethanat e cekura, është hedhur poshtë ankesa.

Me datë 06 prill 2023, paditësi përmes postës e ka dërguar në DHPGJS një ankesë kundër Aktvendimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-15-0277, të datës 20 mars 2023, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të shfuqizohet Aktvendimi i ankimuar dhe të detyrohet Autoriteti i Likuidimit të NSH Fabrika e Konstruksioneve Metalike "Utva" në Pejë, që ta përmbaron në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, C.nr.133/03, të datës 27.10.2004, dhe të gjithë punëtorëve të u paguhet shuma e gjykuar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë ose, lënda të kthehet në Shkallën e I-rë në DHPGJS në rigjykim. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se lidhur me padinë e tij për pagesën e pagave për periudhën e cekur të datës 27 maj 1997 është nxjerrë Aktgjykimi i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.133/03, i datës 27.10.2004, me të cilën është aprovuar padia për paga në tërësi si e bazuar. Paditësi pohon se AKM-ja më pas edhe AKP-ja, kanë qenë të njoftuar me zhvillim e këtyre procedurave në Gjykatën Komunale në Pejë. Në anekse paditësi i është referuar të gjitha zhvillimeve që kanë ndodhur në lidhje me këtë kontest duke filluar nga Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Mlc.nr.2/2005, e datës 16.02.2005, me të cilën ishte refuzuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit Publik të Kosovës dhe vendimet e mëpastajshme që janë marrë në Gjykatën Komunale në Pejë dhe në Gjykatën e Qarkut në Pejë, e cila gjykatë kishte lejuar përsëritjen e procedurës, dhe atë pas kalimit të afatit pesë vjeçar, dhe në kohën kur NSH-ja ka qenë në procedurë të likuidimit. Paditësi pohon se Shkalla e I-rë e DHPGJS-së e ka hedhur poshtë ankesën me arsyetimin që është një Aktgjykim i plotfuqishëm i Gjykatës Komunale në Pejë, dhe është çështje e gjykuar, ndërsa nuk e ka detyruar Autoritetin e Likuidimit ta zbatojë këtë Aktgjykim të plotfuqishëm. Në ankesë ai konsideron se Gjykata ka vepruar me dy kute, duke pranuar kërkesën për përsëritjen e procedurës të parashtruar nga AKP-ja në kohën e procedurës së likuidimit, dhe pastaj përsëri gjykata e pranon kërkesën për ndërprerje të procedurës deri në përfundim të procedurës së likuidimit. A thua kërkesat e AKP-së u dashkan të pranohen në çdo kohë dhe pa marrë parasysh afatet apo jo në procedurën e likuidimit. Në këtë rast DHPGJS-ja është dashur ta

obligoj Autoritetin e Likuidimit ta zbatojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.133/03, të datës 27.10.2004, dhe tu paguhen punëtorëve pagat e pa paguara në shumën e gjykuar.

Me datë 16 qershor 2023, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se në bazë të padisë të paditësit dhe një grupi të punëtorëve të NSH-së Fabrika e Konstruksioneve Metalike "Utva" në Pejë, të datës 26 maj 1997, Gjykata Komunale në Pejë me Aktgjykimin C.nr.133/03, të datës 27.10.2004 e aprovon padinë e paditësit si të bazuar dhe e detyron NSH-në e paditur që t'ia u paguajë paditësve pagat e pa paguara për periudhën 01.06.1995 e deri 31.03.1999, secilit veç e veç shumën prej 4.998,00 euro, me kamatë ligjore.

Ky Aktgjykim e ka vulën e plotfuqishmërisë nga e cila shihet se është bërë i plotfuqishëm me 28 dhjetor 2004.

Tutje Kolegji i Apelit vëren se Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Mlc.nr.2/2005, të datës 22 mars 2005 e refuzon si të pa bazuar kërkesën e Prokurorit Publik të Kosovës për anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.133/03, të datës 27.10.2004.

Kolegji i Apelit po ashtu vëren se sipas kërkesës së AKP-së të paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Pejë, kjo gjykatë me Aktvendimin Ac.nr.141/2011, të datës 20 prill 2011, e aprovon kërkesën e AKP-së, e lejon përsëritjen e procedurës e përfunduar me Aktgjykim të plotfuqishëm, dhe e anulon Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë C.nr.133/03, të datës 27.10.2004.

Pas lejimit të përsëritjes së procedurës, Gjykata Themelore në Pejë me Aktvendimin C.nr.1022/15, të datës 08 shkurt 2016 e pezullon procedurën lidhur me padinë, për shkak se NSH-ja është në likuidim. Ky Aktvendim është vërtetuar edhe me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.949/16, të datës 20 prill 2016.

Pas këtyre zhvillimeve që ka ndodhur në këtë kontest gjyqësor, Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, se bëhet fjalë për çështje të gjykuar, ose bëhet fjalë për ekzistimin e Aktgjykimit të plotfuqishëm. Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Pejë në fakt ishte edhe i plotfuqishëm, para kohës së marrjes së Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, Ac.nr.141/2011 të datës 20 prill 2011, meqë as Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Mlc.nr.2/2005, të datës 22 mars 2005, nuk e kishte anuluar këtë Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Pejë, mirëpo më vonë i njëjti Aktgjykim është anuluar me Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë Ac.nr.141/2011, të datës 20 prill 2011. Kolegji i Apelit nuk do të marrë qëndrim për ligjshmërinë e këtij Aktvendimi të Gjykatës së Qarkut në Pejë, me që nuk është objekte i kësaj ankese.

Kolegji i Apelit në këtë rast është i kufizuar vetëm në shqyrtimin e ligjshmërisë së Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, me të cilin është hedhur poshtë

ankesa e paditësit, të paraqitur ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit, të nxjerrë në procedurën e likuidimit.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi ka bërë përpjekje maksimale për ta realizuar të drejtën e tij në paga për periudhën e cekur, që ishte njohur me Aktgjykimin e anuluar, por kërkesa e tij për paga tek Autoriteti i Likuidimit është refuzuar me arsyetimin që paditësi nuk ka një vendim të formës së prerë, që ja jep të drejtën në paga për periudhën e cekur.

Shkalla e I-rë fare nuk është marrë me vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, që ishte edhe objekt i ankesës së paditësit, ndërsa e hedhë poshtë ankesën për shkak se çështjen e konsideron si çështje të gjykuar, edhe pse në fakt kjo tani nuk mund të konsiderohet se është çështje e gjykuar, meqë është fakt që Gjykata e Qarkut në Pejë e ka lejuar përsëritjen e procedurës sipas padisë të datës 26 maj 1997. Madje kjo procedurë tashmë është edhe pezulluar me Aktvendimin e fundit të Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.1022/15, të datës 08 shkurt 2016.

Prandaj nga këto arsye, Kolegji i Apelit e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar, e anulon Aktgjykimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, dhe çështjen kontestuese në mes të palëve e kthen në rigjykim.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së në procedurën e rigjykimit duhet të merret me meritat e kërkesës së paditësit për paga, natyrisht në bazë të provave ekzistuese dhe provave të reja që mund të sjellin palët në procedurën në vazhdim.

Pastaj pas procedurës së zbatuar të provave, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së duhet të vendos në merita lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Prandaj nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesi tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore me datë 18 korrik 2023 në shumë prej 30 euro, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 14 mars 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
